“Vini re! Kjo botë është e mallkuar dhe çdo gjë që është në të është e mallkuar, përveç përmendjes së Allahut, asaj që është në përputhje me të, dijetarit dhe kërkuesit të dijes.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: “Vini re! Kjo botë është e mallkuar dhe çdo gjë që është në të është e mallkuar, përveç përmendjes së Allahut, asaj që është në përputhje me të, dijetarit dhe kërkuesit të dijes.”

[Hasen] [Transmetojnë Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe]

Profeti në këtë hadith tregoi se kjo botë dhe gjithçka që gjendet në të janë të urryera tek Allahu, të qortuara, të braktisura dhe të larguara nga mëshira e Tij. Edhe gjithçka që ndodhet në të është e braktisur dhe nuk meriton lavdërim, sepse kjo botë dhe çfarë ka në të e largojnë njeriun nga Allahu i Lartësuar dhe e shpërqendrojnë prej Tij. Përjashtim bën përmendja e Allahut dhe çdo gjë që është në përputhje me të dhe i ngjan asaj, të cilën Allahu e do, si edhe dijetari i thelluar në dijen fetare që ua mëson atë njerëzve, ose kërkuesi i kësaj dijeje.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/3788